



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.12

20 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.6396 datë 11.2.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	377
Vendim i KM nr.60, datë 3.2.2010	Për miratimin e marrëveshjes së grantit IDF, nr.TF 094711, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin “Fuqizimi dhe vënia në zbatim e konventës Aarhus”.....	377
Vendim i KM nr.62, datë 3.2.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike”, Vlorë.....	386
Vendim i KM nr.63, datë 3.2.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë – Milot.....	387
Vendim i KM nr.64, datë 3.2.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë- Krujë – Milot.....	390
Vendim i KM nr.66, datë 3.2.2010	Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore.....	394
Vendim i ERE nr.10, datë 8.2.2010	Për licencimin e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k.....	395
Vendim i ERE nr.11, datë 8.2.2010	Për licencimin e shoqërisë “Hidroalbania Energji” sh.p.k...	396
Vendim i ERE nr.12, datë 8.2.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “C&S Construction Energy” sh.p.k.....	397

Vendim i ERE nr.13, datë 8.2.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k.....	398
Vendim i ERE nr.14, datë 8.2.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Cable System” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	399
Vendim i ERE nr.15, datë 15.2.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “400 kv” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..	400
Kërkesë METE nr.2228/7, datë 3.2.2010	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë, truall, arë, pemëtore, ullishtë” për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë në qarkun Shkodër.....	401

DEKRET
Nr.6396, datë 11.2.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:
Serj Georges Hreiche

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.60, datë 3.2.2010

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT IDF, NR.TF 094711, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI DHE VËNIA NË ZBATIM E KONVENTËS AARHUS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit IDF nr.TF 094711, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin “Fuqizimi dhe vënia në zbatim e konventës Aarhus”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore

BANKE NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1818 H Street N.W.
Washington D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

29 tetor 2009

SHT Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Shqipëria: Granti IDF për forcimin e projektit të zbatimit të konventës Aarhus
Granti IDF Nr. TF094711

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), propozon t'i japë Marrësit një grant nga Fondi i Zhvillimit Institucional ("IFD") të Bankës Botërore një shumë që nuk kalon treqind e shtatëdhjetë mijë dollarë amerikanë (US \$370 000) ("Granti"), sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë letër marrëveshje ("Marrëveshja") që përfshin aneksin e bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e aktiviteteve të përshkruara në aneks ("Projekti").

Marrësi, nëpërmjet konfirmimit të pëlqimit të tij më poshtë, demonstroi se është i autorizuar ta lidhë këtë Marrëveshje dhe të zbatojë projektin në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, duke caktuar një punonjës të autorizuar të Marrësit të nënshkruajë dhe vendosë datën në kopjen e bashkëlidhur të kësaj Marrëveshjeje dhe duke e kthyer atë tek Banka Botërore.

Me marrjen nga Banka Botërore të kopjes së sigluar, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e siglimit; me kusht që, oferta e kësaj Marrëveshjeje të konsiderohet e tërhequr, nëse Banka Botërore nuk ka marrë një kopje të sigluar të kësaj Marrëveshjeje brenda 90 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, përveç rastit kur Banka Botërore cakton një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Camille Nuamah
Menaxher Vendi
Shqipëri

Rënë dakord:
Shqipëria

Nga: _____
Përfaqësues i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Datë: _____

Bashkëlidhur:

1) Kushte standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 1 korrik 2008.

2) Letër disbursimi e datës 29 tetor 2009, së bashku me udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet e datës 1 maj 2006.

Granti IDF Nr TF094711

Aneks

Neni 1

Kushtet standarde; përkufizime

1.01 Kushtet standarde. a) Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 1 korrik 2008 (“Kushte standarde”) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshjeje.

Neni 2

Ekzekutimi i projektit

2.01. Objektivat dhe përshkrimi i projektit. Objektivi i projektit është forcimi i kapaciteteve të marrësit dhe shoqërive civile për të zbatuar konventën Aarhus “Mbi aksesin në informacion, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore” (“AaC”). Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A: Forcimi i kapacitetit institucional dhe kuadri ligjor

Dhënia e asistencës teknike në forcimin e kapacitetit institucional të Marrësit dhe kuadrin ligjor nëpërmjet: i) vlerësimit të kuadrit ligjor ekzistues dhe kapacitetit institucional për zbatimin dhe aktivitetin e qendrave kryesore dhe rajonale AaC, duke përfshirë kërkesat e tyre për trajnim; ii) përgatitja e udhëzimeve dhe procedurave për informacionin mbi mjedisin, përfshirjen publike dhe konsultimet dhe ushtrimi i të drejtave në gjykatat administrative dhe të zakonshme; iii) përditësimi i strategjisë së Marrësit dhe plani i veprimit (Strategjia dhe plani i veprimit për zbatimin e konventës Aarhus në Shqipëri 2005) mbi zbatimin e kërkesave AaC; dhe iv) ngritja e një rrjeti për agjencitë mjedisore rajonale.

Pjesa B: Shpërndarja e njohurive, trajnimi dhe informacioni

Sigurimi i mallrave, asistencës teknike dhe trajnimit në shpërndarjen e njohurive, trajnimit dhe informacionit në lidhje me AaC në Shqipëri nëpërmjet: i) fillimit të fushatave informative, zhvillimit të materialeve të trajnimit dhe zhvillimit të programeve të trajnimit për të korrigjuar mungesën e kuptimit publik dhe rritja e ndërgjegjësimit për shtyllat e AaC; ii) përditësimi i faqes së internetit AaC dhe lidhjet me bazën e të dhënave online; dhe iii) publikimi i manualeve mbi udhëzimet dhe procedurat për dispozitat e informimit mbi mjedisin, përfshirjen e publikut në konsultime dhe paraqitja e pretendimeve.

Pjesa C: Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë

Sigurimi i mallrave, asistencës teknike dhe trajnimit për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile për mjedisin – proceset përkatëse të planifikimit të Marrësit nëpërmjet një monitorimi sistematik të udhëzimeve dhe kërkesave të parashikuara në konventën Aarhus, si dhe nëpërmjet forumeve publike ku rezultatet i bëhen të ditura auditorëve më të gjerë.

2.02. Ekzekutimi i grantit në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit dhe grantit. Për këtë qëllim, Marrësi zbaton projektin, nëpërmjet Qendrës së Informimit

Aarhus pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve, Administrimit të Ujërave (MAPAU) dhe në bashkëpunimin me Drejtorin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Lejet në MAPAU kryen prokurimin, menaxhimin financiar dhe masat e auditimit të projektit, nëpërmjet njësisë qendrore të financimit dhe kontraktimit (CFCU) pranë Ministrisë së Financave (MF), në pajtim me dispozitat : a) e nenit II të kushteve standarde; b) e “udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projekte të financuara nga huatë e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s” të datës 15 tetor 2006; dhe c) ky nen II.

2.03. Masat institucionale dhe të tjera. Marrësi siguron fonde të mjaftueshme për: i) ambientet e zyrave; ii) kohën e personelit homolog; iii) kohën e personelit që trajnohet; iv) mbështetjen administrative, dhe v) auditimin.

2.04. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit a) Marrësi monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe, me kërkesë të Bankës Botërore, përgatit raportet e projektit, në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të parashikuar më poshtë në paragrafin (b) të këtij seksioni. Secili raportprojekti mbulon atë periudhë që tregohet në kërkesën e Bankës Botërore dhe i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas datës së kësaj kërkesë.

b) Treguesit e punës të përmendur në paragrafin (a) përbëhen nga sa më poshtë:

i) Vendimet e qeverisë në pajtim me kriteret AaC janë shtuar deri më 30 tetor 2012.

ii) Numri i individëve dhe organizatave të trajnuara mbi AaC është rritur në të paktën 250 individë deri më 30 tetor 2012.

iii) Lidhja në rrjet dhe baza e të dhënave është bërë dhe është funksionale më 30 tetor 2012.

iv) Plani i veprimit dhe strategjia e Marrësit, e përditësuar më 30 tetor 2012.

c) Marrësi, me kërkesë të Bankës Botërore, përgatit raportin e përfundimit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti i përfundimit i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se pesë muaj pas datës së mbylljes.

2.05. Menaxhimi financiar. a) Marrësi siguron që sistemi i menaxhimit financiar të mirëmbahet në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi siguron që raportet financiare të përkohshme të paaudituar të projektit të përgatiten dhe t'i paraqiten Bankës Botërore, si pjesë e raportit të projektit jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të secilit semestër kalendarik, duke mbuluar semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi auditon pasqyrat financiare, në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07(b) të kushteve standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon të gjithë periudhën gjatë së cilës janë bërë tërheqjet nga llogaria e grantit. Pasqyrat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë i jepet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.06. Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat dhe shërbimet e kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga shumat e grantit prokurohen, në pajtim me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në:

i) Seksionin I (duke përjashtuar paragrafin 1.16) të “Udhëzimeve për prokurimin sipas huave IBRD dhe kreditë IDA” publikuar nga Banka Botërore në maj 2004 (“Udhëzimet e prokurimit”), në rastin e mallrave; dhe

ii) Seksionet I (duke përjashtuar paragrafin 1.24) dhe IV të “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore”) të publikuara nga Banka Botërore në maj 2004 dhe rishikuar në tetor 2006 (“Udhëzimet për konsulentë”) në rastin e shërbimeve të konsulentëve.

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të caktuara, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në udhëzimet e prokurimit, ose udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

c) Metoda të caktuara të prokurimit të mallrave. Mallrat prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e blerjes.

d) Metoda të caktuara të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve:

i) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në pikën (ii) më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe koston.

ii) Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato porosi që Banka Botërore bie dakord të përmbushin kërkesat e parashikuara në udhëzimet e konsulentëve për përdorimin e tyre: A) Përzgjedhje me koston më të ulët; B) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; C) Përzgjedhje e konsulentëve individualë D) Procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Përveç rasteve kur Banka Botërore përcakton ndryshe nëpërmjet një njoftimi drejtuar Marrësit, kontratat e mëposhtme i nënshtrohen rishikimit pasues nga Banka Botërore: a) kontrata e blerjes së parë për mallrat pavarësisht nga vlera e tyre; b) secila kontratë me individë e llogaritur me një kosto më të lartë se 20 000 USD; c) kontrata e parë CQ pavarësisht nga vlera e saj; dhe d) të gjitha termat e referencës për shërbimet e konsulentëve. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqjet e shumave të grantit

3.01 Shpenzime të përshtatshme. Marrësi mund të tërheqë shumat e grantit, në pajtim me dispozitat e a) nenit III të kushteve standarde, b) këtij seksioni, dhe c) çdo udhëzimi shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin (duke përfshirë udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet) të muajit maj 2006, që rishikohet herë pas here nga Banka Botërore dhe që bëhet e zbatueshme në këtë Marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e përshtatshme, të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Tabela përcakton kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme, që mund të financohen nga shumat e grantit ("Kategori"), alokimin e shumave të grantit për secilën kategori, dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e përshtatshme në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e grantit e alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohet
1) Mallra, shërbime dhe trajnime dhe seminare	370 000	100%
Shuma e përgjithshme	370 000	

Për qëllimet e këtij seksioni, termi "Trajnim dhe seminar" do të thotë shpenzimet e bëra për të financuar koston e organizimit dhe zhvillimit ose pjesëmarrjes në aktivitetet e trajnimit, si biseda, seminare, konferenca, duke përfshirë pagesat e tarifave për shërbimet e konsulentëve të parashikuara për këto aktivitete trajnimi.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së kundërsiglimit të kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është tre vjet pas datës së kundërsiglimit të kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi.

Neni 4

Përfaqësuesi i marrësit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4, Tiranë, Shqipëri
Faks. +355 42 28494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Kablllore:
INDVAS
Washington D.C.

Teleks:
248423(MCI) ose
64145(MCI)

Faks.
1-202-477-6391

Banka Botërore

BANKË NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1818 H Street N.W.
Washington D.C. 20433
USA.

(202) 477-1234
Adresa kablllore: INTBAFRAD
Adresa kablllore: INDEVAS

30 tetor 2009

SHT Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Shkëlqesi,

Lënda: Shqipëri: Granti Nr. TF094711
Grant për Forcimin e Projektit të Zbatimit të Konventës Aarhus
Udhëzime shtesë: Disbursimi

I referohem letërmarrëveshjes (“Marrëveshja”) ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), si administratore e fondeve të grantit nga Fondi i Zhvillimit Institucional i Bankës Botërore (“IFD”), dhe Shqipërisë (“Marrësi”) për projektin e përmendur më sipër, të datës 29 tetor 2009. Marrëveshja parashikon që Banka Botërore mund të nxjerrë udhëzime shtesë, në lidhje me tërheqjen e shumave të grantit Nr. TF094711 (“Granti”). Kjo letër (“Letër disbursimi”), e rishikuar herë pas here, përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet të datës 1 maj 2006, bashkëngjitur, (“Udhëzimet e disbursimit”) (shtojca 1), janë një pjesë përbërëse e letërës së disbursimit. Mënyra në të cilën dispozitat e udhëzimeve të disbursimit zbatohen për grantin është e përcaktuar më poshtë. Seksionet dhe nënseksionet në parantezë më poshtë u referohen seksioneve dhe nën-seksioneve përkatëse në udhëzimet e disbursimit dhe, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë letër, termat me germa kapitale të përdorura kanë kuptimet që u jepen atyre në udhëzimet e disbursimit.

I. Masat e disbursimit

i) Metodat e disbursimit (seksioni 2). Metodat e mëposhtme të disbursimit mund të përdoren për këtë grant:

- Riimbursim;
- Parapagim;
- Pagesë e drejtpërdrejtë;
- Detyrim i veçantë.

ii) Data e fundit e disbursimit (nënseksioni 3.7). Data e fundit e disbursimit është 4 muaj pas datës së mbylljes së përcaktuar në Marrëveshjen e grantit. Çdo ndryshim deri në këtë datë njoftohet nga Banka Botërore.

II. Tërheqjet e shumave të grantit

i) Nënshkrimet e autorizuara (nënseksioni 3.1).

Një letër në formën e bashkëngjitur (shtojcë 2) duhet t'i jepet Bankës Botërore në adresën e treguar më poshtë, duke dhënë emrin(at) dhe ekzemplarët e firmave të punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat:

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: Jane, Armitage, Drejtor Vendi dhe Koordinator Rajonal për Europën Jug-Lindore (Rajoni ECA).

ii) Kërkesat (nënseksionet 3.2-3.3) Jeni të lutur të paraqitni të plotësuar dhe nënshkruar: a) kërkesat për tërheqje, së bashku me dokumentet shoqëruese dhe b) kërkesat për kontribute të veçanta, së bashku me një kopje të letrës së kredisë së bankës tregtare, në adresën e treguar më poshtë:

The World Bank
Radnicka cesta 80, 9th floor
Zagreb, HR-10 000,
Croatia

Në vëmendje të: Grupi i menaxhimit të disbursimit.

iii) Vlera minimale e kërkesave (nënseksioni 3.5) Vlera minimale e kërkesave për pagesë të drejtpërdrejtë dhe/ose lëshimin e kontributeve të veçanta është ekuivalenti i 19 600 USD.

iv) Parapagimet (seksionet 5 dhe 6)

- Tipi i llogarisë së caktuar (nënseksioni 5.3): e ndarë .
- Monedha e llogarisë së caktuar (nënseksioni 5.4): dollarë amerikanë (USD).
- Institucioni financiar ku llogaria e caktuar do të hapet (nënseksioni 5.5): në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën.
- Tavani (nënseksioni 6.1): 98 000 USD.

III. Raportimi mbi përdorimin e shumave të huasë

i) Dokumentacioni shoqërues (seksioni 4) Dokumentacioni shoqërues duhet të paraqitet me secilën kërkesë për tërheqje sipas parashikimit të mëposhtëm:

Për kërkesat për riimbursim:

- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4).
- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh. kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100 000 USD ose më shumë për firma dhe në ekuivalentin e 50 000 USD për konsulentët individë.
- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet/kontratat.

Për raportimin e pagesës së shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar:

- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4).

- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh. kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100 000 USD ose më shumë për firma dhe me ekuivalentin e 50 000 USD për konsulentët individë.

- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet/kontratat.

Për kërkesat për pagesë të drejtpërdrejtë: regjistrat që evidentojnë shpenzime të përshtatshme, p.sh. kopje për fatura, fatura furnitorësh.

ii) Frekuenca e raportimit të shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar (nënseksioni 6.3). Kërkesat për plotësim duhet të paraqiten çdo muaj. Kërkesa për riplotësim duhet të përfshijë pasqyrat rakorduese të bankës, si dhe dokumentet e tjera të përshtatshme shoqëruese.

IV. Informacioni tjetër i rëndësishëm

Për informacion shtesë mbi masat e disbursimeve, jeni të lutur t'i referoheni manualit të disbursimit që ofrohet në faqen publike të Bankës Botërore tek <http://www.worldbank.org> dhe faqet e siguruara "Client Connection" tek <http://clientconnection.worldbank.org>. Kopje të printuara ofrohen me kërkesë.

Nëse nuk e keni bërë këtë, Banka Botërore rekomandon që ju të regjistroheni si përdorues i faqes Client Connection <http://clientconnection.worldbank.org>. Nga kjo faqe ju do të jeni në gjendje të shkarkoni kërkesat, të ndiqni gati në kohë reale statusin e grantit dhe të tërhiqni informacionin përkatës politik, financiar dhe për prokurimin. Për më tepër informacion në lidhje me faqen e internetit dhe masat e regjistrimit, jeni të lutur të kontaktoni Bankën Botërore me e-mail tek clientconnection@worldbank.org.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me sa më sipër, jeni të lutur të kontaktoni z. Nicholay Chistyakov, Financier i Lartë tek loa-ea@worldbank.org duke përdorur referencën e mësipërme.

Sinqerisht i juaji

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Camille Nuamah

Menaxher Vendi

Shqipëri

SHTOJCË

1. Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet, datë 1 maj 2006;
2. Formulari i firmave të autorizuar;
3. Formulari i "Pasqyrës së shpenzimeve";
4. Formulari i pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore.

Përgatitur nga NEC

Miratuar dhe për dijeni: K.B. Propst, B. Morata, LEGEM
Ana Gjokutaj, ECSSD

Për dijeni me kopje: [Njësia e zbatimit të projektit 1]
[Adresa e rrugës]
[qyteti], [vendi]
[adresa elektronike]

[Njësia e zbatimit të projektit 2]
[Adresa e rrugës]
[qyteti], [vendi]
[adresa elektronike]

SHTOJCË 2

(Koka e letrës)
Ministria e Financave
(Adresa e rrugës)
(Qyteti, vendi)

(Datë)

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: (Drejtore Vendi)

I nderuar (Drejtore Vendi):

Lënda:

I referohem Marrëveshjes së grantit (“Marrëveshja”) ndërmjet (Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) dhe Shqipërisë (“Marrësi”), datë _____, që parashikon grantin e mësipërm. Për qëllimet e seksionit 3.04(b) të kushteve standarde, sipas parashikimit në Marrëveshje, cilido¹ nga personat, ekzemplarët autentikë të firmave të të cilëve janë më poshtë, autorizohet në emër të Marrësit të nënshkruajë kërkesat për tërheqje (dhe kërkesat për një kontribut të veçantë) sipas këtij granti:

(Emër), (pozicioni) Ekzemplari i firmës: _____
(Emër), (pozicioni) Ekzemplari i firmës: _____
(Emër), (pozicioni) Ekzemplari i firmës: _____

Sinqerisht i juaji
(firmë)

(pozicioni)

¹ Udhëzimi për Marrësin për dërgimin e kësaj letrë tek Banka Botërore: Parashiko nëse kërkesën duhet ta nënshkruajë më shumë se një person dhe sa ose cilët pozicione dhe nëse zbatohet ndonjë limit.

VENDIM
Nr.62, datë 3.2.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I RRUGËS
“TRANSBALLKANIKE”, VLORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9839, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike” Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, shtetasi Albert Hamdi Veizi, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për 45 (dyzet e pesë) m², sipërfaqe ndërtimi, vlerësuar me çmimin 67 100 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë/m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 3 019 500 (tre milionë e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 3 019 500 (tre milionë e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 15.2.2010 dhe të përfundojë më 15.5.2010.

6. Pronari i listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, të kryejë likuidimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas pikës 5 të këtij vendimi, dhe të dokumentacionit të pronësisë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE
QË PREKET SI REZULTAT I RRUGËS “TRANSBALLKANIKE”**

Lloji i pasurisë së patundshme: objekt

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.Pas.	Sip. totale pron.	ZK	Objekte			Shënime
							Sip. (m ²)	Çmimi L/m ²	Vlefta në lekë	
1	Albert	Hamdi	Veizaj	5/39	45 ND	8604	45	67100	3019500	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali					45		3019500	

VENDIM
Nr.63, datë 3.2.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA ZGJERIMI I
SEGMENTIT RRUGOR FUSHË-KRUJË - MILOT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë - Krujë - Milot.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 196 073 164 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 690 000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 196 073 164 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces saktësimi nga ZRPP-ja”, të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar ky proces, fakt i cili të vërtetohet zyrtarisht po nga ZRPP-ja përkatëse, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

7. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Legalizim” të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe pasi të jetë bërë regjistrimi në ZRPP, fakt i cili të vërtetohet zyrtarisht nga ZRPP-ja përkatëse, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

8. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të jetë paraqitur dokumentacioni i plotë tekniko – ligjor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Për pasurinë, për të cilën në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Me leje ndërtimi/i paregjistruar”, të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të kenë përfunduar procedurat përkatëse të regjistrimit, fakt i cili të vërtetohet zyrtarisht nga ZRPP-ja përkatëse, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

11. Shpronësimi të fillojë më 3.2.2010 dhe të përfundojë më 30.4.2010.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Proces saktësimi nga ZRPP-ja”, “Legalizim”, “Leje ndërtimi”, “Me leje ndërtimi/i paregjistruar” në bazë të pikave 6, 7, 8 e 9 të këtij vendimi, dhe të dokumentacionit të pronësisë, ndërsa për pronarët e konfirmuar të kryejë likuidimin e tyre në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Objektet që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të aksit “Zgjerimi i superstradës Fushë Krujë - Milot”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Objekte

Nr.	Pronari			Z. K	Nr. Pas.	Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji Objektit	Vendodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	VESEL		KEQI	3599	5+6	3982913	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
2	VELI		KEQI	3599	4	3381002	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
3	HAMID		JANGOZI	3599	2/5	290878	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
4	RAMAZAN		JANGOZI	3599	2/6	2452247	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
5	PETRIT		JANGOZI	3599	2/4	525137	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
6	AGIM		JANGOZI	3599	2/3	750917	Shtepi banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
7	OSMAN		DIKA	3599	1	2267662	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
8	MENTOR, BLERIM		RRYCI	3599	32/36	25053966	Pike Karburanti, Lokal, Magazine, Lavazh	Thumane	Konfirmuar nga ZRPP
9	MENTOR, BLERIM		RRYCI	3599	32/35	6875100	Parking	Thumane	Konfirmuar nga ZRPP
10	NEL	BEG	JANGOZI	3599	36/4	4199849	Shtepi Banimi	Thumane	Konfirmuar nga ZRPP
11	FEJZULLA		CAKA	3599	7	4074438	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
12	ALI	HAJDAR	MUZHAQI	3599	28/7/1	1972540	Shtepi Banimi	Thumane	Konfirmuar nga ZRPP
13	VESEL		JANGOZI	3599	2/2	3175816	Shtepi Banimi	Thumane	Proces saktësimi nga ZRPP
14	ALFRED		GJEGJAJ	3599	216/16	4638733	Mu rrethues + Lulishte	Thumane	Konfirmuar nga ZRPP
15	GJON	BARDHOK	BACUKU	3599		1303499	Shtepi Banimi	Thumane	LEGALIZIM Nr 931
16	RAMAZAN	LIMAN	ISHMAKU	1676	157/18	3949857	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
17	PETRIT	DED	STOJANI	1676	158/69	2695775	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
18	GJON	BARDHOK	BACUKU	1676	155/20	2019140	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
19	LEK	BARDHOK	BACUKU	1676	155/13	2076388	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
20	FRANCESK		BACUKU	1676		630905	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.930
21	AHMET	GANI	ZANI	1676	157/16	2820313	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Proces saktësimi nga ZRPP
22	GANI	LIMAN	ZANI	1676	157/17	2810876	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Proces saktësimi nga ZRPP
23	VIKTOR	ZEF	MILLOSHI	1676		4237337	Mur + Mbushje	Fushe Mamurras	LEJE NDERTIMI
24	ISLAM		HASANAJ	1676		7731526	Shtepi Banimi + Lokal	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr 798
25	KUJTIM		ZANI	1676		3259566	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.1078
26	BEQIR		HASANAJ	1676		6266041	Shtepi Banimi + Ambjent Sherbimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.1074
27	BARDHYL	REXHEP	HASANAJ	1676		6658748	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.1075
28	REXHEP	GANI	ZANI	1676	157/15	5904312	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
29	XHEVDET	HAMDI	ZANI	1676		2338097	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.1077

30	BAKIE	ADEM	FERA	1676	200/1	1857779	Shtepi Banimi	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
31	ZENEL	HASAN	HASANAJ	1676		1623176	Servis	Fushe Mamurras	LEGALIZIM Nr.801
32	PETRIT	DED	STOJANI	1676		2606871	Lokal Sherbimi	Fushe Mamurras	LEGALIZIM NR.805
33	GJON	NIKOLL	RECI	1676	105/8+106/6	19037268	Pike Karburanti	Fushe Mamurras	Konfirmuar nga ZRPP
34	ALTIN	GJON	BIBA	1677	29/24	7542871	Lokal	Fushe Milot	Konfirmuar nga ZRPP
35	BESNIK		SULAJ	1677		4539358	Gomisteri	Fushe Milot	ME LEJE NDERTIMI/ I paregjistruar
36	NIKOLL	GJERGJ	GJECI	1768		2138104	Shesh Ndertimi + Mur Mbajtes	Gjorm	LEJE NDERTIMI
37	BARDH	DOD	RICA	1768	59/32/1	2557227	Pike Karburanti	Gjorm	Konfirmuar nga ZRPP
38	GJERGJ	LULASH	BUJARI	1768	15/25/1	3946677	Pike Karburanti	Gjorm	Konfirmuar nga ZRPP
39	GJON	DOD	RICA	1768	59/34/2	8040932	Pike Karburanti	Gjorm	Konfirmuar nga ZRPP
40	FREDERIK	MATI	FRROKAJ	1768		1231200	Shesh Ndertimi	Gjorm	LEJE NDERTIMI
41	SANDER	MATI	FRROKAJ	1768		3659400	Shesh Ndertimi	Gjorm	LEJE NDERTIMI
42	NDUE	MARK	ZEFI	2365	355/17	8044815	Pike Karburanti	Fshat Laç	Konfirmuar nga ZRPP
43	TACI OIL			3441	10/22	10903906	Pike Karburanti	Shullaz	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				196073164			

VENDIM
Nr.64, datë 3.2.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT
RRUGOR FUSHË- KRUIË - MILOT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë-Kruië – Milot.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 44906 (dyzet e katër mijë e nëntëqind e gjashtë) m², tokë arë, me vlerë 18 955 868 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, për sipërfaqen 8962 (tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) m², tokë truall, me vlerë 18 820 200 (tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet mijë e dyqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 37 776 068 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 057 500 (një milion e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 37 776 068 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.2.2010 dhe të përfundojë më 15.5.2010.

7. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces saktësimi”, të bëhet kompensimi, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar ky proces, në bazë të konfirmimit që do të merret nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kruië, dhe të dokumentacionit të pronësisë.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është dhënë konfirmimi nga ZRPP-ja, Kruië, me “Barrë hipotekore”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë shlyer detyrimet ligjore dhe pasi pasuria përkatëse të jetë e lirë nga çdo barrë e vendosur mbi të, fakt i cili do të provohet po në bazë të një konfirmimi të dhënë nga ZRPP-ja përkatëse dhe dokumentacioni i pronësisë.

9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Proces saktësimi” dhe “Barrë hipotekore”, sipas pikave 6,7 e 8 të këtij vendimi, ndërsa për pronarët e konfirmuar të kryejë likuidimin në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS "THUMANË-MILOT"

Qarku: Durrës

Fshati: BUSHNESH

NR	Pronari			Nr. Pas.	Arë			Truall			Vlera Totale Lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		
1	ANTON GJERGJI			1332	72/17	231	327	75537			75537	Konfirmuar nga ZRPP
